

FLETE PALOSJE

Të nderuar taksapagues të njësisë vendore Kamëz!

Viti i ri fiskal 2012 ka filluar dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka përgatitur gjithë infrastrukturën e nevojshme në pritje të taksapaguesve (biznesmen dhe familjare) për tu njohur me detyrimet që **Ju** keni për taksë dhe tarifa vendore ndaj Bashkisë Kamëz.

Sjellim në vemendjen Tuaj që afati i fundit për pagesën e taksave lokale (taksë dhe tarifa fikse) është **data 20.Prill.2012.**

Mospagesa e këtij detyrimi brënda dates se përcaktuar me ligj u penalizon me **gjobe, 25%** të vlerës së detyrimit që subjekti Juaj ka ndaj Bashkisë Kamëz.

Taksë vendore e biznesit të vogël do të vazhdojë të paguhet me këste në përputhje me ligjin 9632 datë 20.10.2006 i ndryshuar dhe me paketën fiskale të miratuar me vendim nr. 39 date 25.11.2011 përkatësisht sipas datave të mëposhtme:

- **Kësti I deri me 20 Prill 2012**
- **Kësti II deri me 20 Korrik 2012**
- **Kësti III deri me 20 Tetor 2012**
- **Kësti IV deri me 20 Janar 2013**

Mospagesa e këstit të radhës brënda datave të mësipërme ju penalizon me **gjobe, 25%** të vlerës së detyrimit të papaguar.

Për ç'do paqartësi dhe shpjegim më të hollësishëm në lidhje me detyrimet që ju keni për taksat dhe tarifën vendore mund të drejtoheni pranë **One Stop Shop-it** perkatesisht në sportelin e **Tatim-Taksave** në Bashkinë Kamëz, pasi të keni marrë **Njoftim-Vleresimin** tatimor për vitin 2012 dorazi ose në mënyrë postare.

Duke besuar në një mardhënie të drejtë dhe të sigurtë partneriteti midis zyrës së taksave vendore dhe taksapaguesve si dhe duke njohur kontributin Tuaj të pazevendesueshem në zhvillimin e gjithanshem të qytetit të Kamzës, ju mirepresim.

Faleminderit!